

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 111 Rep.

Nr. Kol.

705

Majlinda E. Demollari
Taksa e Putes
U Paga



KONTRATË PËR SHITJE – BLERJE

(kuotat e kapitalit themeltar)

Sot më datë 16.03.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), përpara meje noteres Majlinda E. Demollari, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me Seli në Qytetin e Tiranës, Rr. "Vaso Pasha" ish-blloku, u paraqitën personalisht personat e mëposhtëm:

Z.Fatmir Hysenbelliu, i lindur më 04.04.1992 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. 029274486 dhe Nr. Personal J20404060Q, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotërues i 70% të kuotave të shoqërisë "Technology Solution Albania" sh.p.k., (më poshtë referuar si Shitësi).

Gentjan Progni, i lindur më 03.08.1989 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. 024522739 dhe Nr. Personal I90803058R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotërues i 30% të kuotave të shoqërisë "Technology Solution Albania" sh.p.k. (më poshtë referuar si Blerësi).

Të sipërpermendurit, bazuar në *nemin 73 të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nemin 705 dhe vijues të Ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, statutin e shoqërisë "Technology Solution Albania" SHPK kërkuan prej meje noteres përpilimin e kësaj "Kontrate për shitje kuotash" si më poshtë:

Neni 1

Kushtet Paraprake

Shitësi është Ortak i 70 % (shtatëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Technology Solution Albania" SHPK (më poshtë referuar si "Shoqëria"), me numër identifikimi Nipt- L81324040R.

Neni 2

Objekti i Kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga Shitësi te Blerësi, e 100 % (njëqind përqind) të kuotave që Shitësi zoteron si ortak i i shoqërisë "Technology Solution Albania" sh.p.k.

Neni 3

Çmimi i Shitjes

Çmimi i shitjes së kuotave nga Shitësit tek Blerësi, sipas marrëveshjes midis palëve, është **70.000 lekë (shtatëdhjet mijë lekë)**.

Neni 4

Detyrimet e Shitësit

- 4.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë "Technology Solution Albania" sh.p.k., kuota të cilat tashmë i kalojnë blerësit.
- 4.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.
- 4.3 Shitësi do të marrë të gjithë masat e nevojshme për të garantuar përbushjen e detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe në zbatim të kësaj kontrate.
- 4.4 Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet/taksat e parashikuara prej legjislacionit shqiptar në lidhje me këtë kontratë.

Neni 5

Detyrimet e Blerësit

- 5.1 Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.
- 5.2 Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 5.3 Blerësi merr përsipër të përbushë ndaj të treteve, detyrimet e cdo lloji të lindura përpara hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Neni 6

Përbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme. Ndryshimet apo shmanget e mundshme nga kjo kontratë, mund të bëhen vetëm me shkrim duke u nënshkruar nga të gjitha palët dhe më pas i bashkëngjiten kontratës si pjesë përbërëse e saj.

Neni 7

Legjislacioni i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

7.1 Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

7.2 Çdo mosmarrëveshje midis palëve që rrjedh nga apo lidhet me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhet me marrëveshje midis palëve. Në rast të kundërt, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

Në përputhje me *nemin 74* të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), kjo kontratë hyn në fuqi midis palëve që në momentin e nënshkrimit të saj.

Neni 9

Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë përgatitet në 4 ekzemplarë në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Pas përpilimit të kësaj kontrate, Unë noterja e lexova atë me zë të lartë. Shitësi dhe Blerësi, më deklaruan se e kuptuan përbajtjen e kësaj Kontrate dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e pranuan dhe e nënshkruan atë në praninë time.

PALA BLERËSE

Z.Gentjan Progni

Gentjan Progni

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

PALA SHITËSE

Z.Fatmir Hysenbelliu

Fatmir Hysenbelliu

NOTERI
Majlinda E. Demollari
NIP: 2011080401
Tel: 0678061560